



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Debati publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2024-2026 – Sektori i Arsimit

Debatin publik e hapi drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Fatlum Osmani duke iu uruar mirëseardhje të gjithë të pranishmeve që po marrin pjesë në debatin publik për KAB 2024-2026, ai theksoi që përveç që debati është i hapur për të gjithë, në mënyrë specifike është me përfaqësuesit e institucioneve arsimore në mënyrë që të diskutojnë prioritetet dhe kërkesat të cilat duhet të inkuadrohen në KAB.

Drejtori Osmani tha se komuna e Podujevës në mënyrë të vazhdueshme ka rritje të konsiderueshme të buxhetit në bazë të Qarkores Buxhetore nga Ministria e Financave, ku komuna e Podujevës për vitin 2023 ka 31,423,020.00 euro , për dallim nga ky vit ku është një buxhet prej 27 mil, ku është një rritje rreth 4 mil euro, mirëpo një pjesë e madhe e këtyre mjeteve financiare do të jenë në kategorinë e pagave, si rezultat i inkuadrimit të ligjit të pagave nga viti 2023.

Limtet buxhetore përcaktohen nga drejtorja e Financave, mirëpo ka edhe disa grande, sic është grandë specifik për arsim, grandë specifik për shëndetësi, grandë i përgjithshëm dhe të hyrat vetanake. Arsyeja e këtyre e ketyre takimeve është të bisedojmë me bashkëqytetarë dhe me grupe të interesit sic është sot sektori i Arsimit, në mënyrë që bashkarisht të ndërtojmë prioritetet dhe projektet të cilat do të inkuadrohen në KAB, që është një dokument i cili i paraprin hartimit të buxhetit për vitin 2024 të Komunës së Podujevës.

Për vitin 2024 edhe ne bazë të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal edhe ne bazë të Kornizës Afatmesme Buxhetore të aprovuar në vitet paraprake, ne i kemi kushtuar prioritet fushës së Shëndetësisë, Arsimit, Kulturës, Bujqësisë, Ekonomisë ku kemi projekte të rëndësishme të cilat financohen nga buxheti i Komunës së Podujevës.

Arsimi pa dyshim vazhdon të mbetet prioritet i Komunës së Podujevës, ku projektet në fushën e arsimit janë në procedura të prokurimit dhe tani gjatë pushimeve verore do të ketë investime në fushën e arsimit në bazë të nevojave dhe kërkesave, por sigurisht ka edhe projekte tjera madhore sic është ndërtimi i shkollës së mesme ekonomike “Isa Boletini”, projektet të cilat janë me efikasitet të energjisë, ndërtimi i qerdheve, ndërtimi i sallave të edukatës fizike dhe kështu do të vazhdojmë në vitet në vijim, në mënyrë që sektori i arsimit të ketë kushte optimale për procesin e mësimin, njëjtë është edhe për fushën e shëndetësisë, ku për këtë vit disa projekte janë përfunduar, e një ndër më të rëndësishmet është duke u ndërtuar Urgjenca e qytetit, e cila është në bashkëfinancim me “Katar Charity”, përveç këtyre sektoreve edhe çështjet infrastrukturore vazhdojnë të jenë prioritet i buxhetit, ku kemi rritje të investimeve, sic është ndërtimi i kolektorit për ujra të zeza, ndërtimi i rrugëve “Skënderbeu”, “Xhemjal Mustafa”, pastaj rruga nga lumi Ilap deri te magjistraja, por edhe rrugë të tjera ku do të ketë edhe në qytet edhe në fshatra. Nuk dua të zgjas më shumë vetëm deshta të bëj një rezymë të përgjithshme të Korinizës Afatmesme Buxhetore ku të gjithë jeni të mirëseardhur me kërkesat dhe sygjerimet e juaja tha drejtori Osmani.

Drejtori Naim Bajrami i shkollës “Zahir Pajaziti” në Orllan, thekson si nevojë urgjente ndërtimin e fushës së sportit, ngrohjet janë problemi më i madh që kemi, gjithashtu pullazi i shkollës lëshon ujin, 5 hyrjet e shkollës janë në gjendje të tmerrshme, defekte shumë të mëdha, shkolla ka nevojë për gelqerosje, një kënd të lojrave, shkolla ka shumë pak radiator sepse hapësira e shkollës është shumë më e madhe sesa kapaciteti i këtyre radiatorave, gjithashtu rrethoja është shumë e nevojshme për oborrin e shkollës përfundoi drejtori Bajrami.

Drejtori i Arsimit, Avni Fetahu, keni parasysh që po diskutojmë për planifikim të buxhetit të vitit 2024, për probleme teknike të cilat i kemi trashëguar, kemi kontrata që priten mu lidh në vlerë gjysme milion euro, për rregullimin dhe riparimin e këtyre problemeve.

Kosovare Namani- nga fshati Shamalluk, arsyeja pse kemi ardh në këtë dëgjim buxhetor është rruga e cila po bën shume probleme e cila është me një gjatësi prej rreth 700 metrave, dhe e cila dita ditës po bahet e pakalushme, problemi më i madh është të njerëzit që po merren me kultura bujqësore dhe që merren me rritjen e deleve, ju kisha lut që te pakten të shtrohet një shtresë me zhavor dhe të hapet një kanalizim.

Nysret Ismajli- drejtor i Shkollës “Shaban Shala” në Podujevë, unë kam një kërkesë për 2024, ne i kemi dy hyrje të shkollës të cilat janë dëmtuar shumë nga punimet që i kemi patur gjatë këtij viti, gjithashtu ne kemi shumë nxënës dhe paraqitet nevoja për një sallë ku mund të mbahen aktivitet sportive, takimet komunale dhe ato të organizatave të shoqërisë civile.

Drejtori i shkollës së Dumniceës, Mustaf Miftari, kërkesë ka ndërtimin e fushës sportive në shkollën e fshatit.

Drejtori i shkollës fillore në Metehi – Adil Haliti, një pyetje për drejtorin e Arsimit, se a është planifikuar fusha e sportit në fshatin Metehi për vitin 2023, nëse jo atherë është kërkesë e komunitetit tonë që të ndërtohet, ndërsa kërkesë tjetër kemi edhe rrethojën e shkollës me parking.

Një banore e fshatit Shamalluk- ngrit ceshtjen e rruges në Shamalluk, për rregullimin e rrugës me zhavor, sepse po i dëmton në aktivitetine tyre bujqësor.

Drejtori Osmani fillon përgjigjet duke filluar nga kërkesa e fshatit Shamalluk e cila edhe me buxhetin e vitit 2023 do të trajtohet me zhavor, kërkesat tjera të cilat ishin për terrenet sportive në fshatin Dumniceë dhe Metehi po besojmë që në vitin e ardhshëm do të trajtohen këto kërkesa dhe do të bëjmë përpjekje maksimale për realizim, ndërsa për sallat e edukatës fizike në Orllan dhe tek shkolla “Shaban Shala” kemi bërë kërkesë tek ministria e Arsimit, por janë të inkuadruar edhe në KAB, por jo të 2024, sepse është e pamundur të inkuadrohen në 2024 por do të jenë në vitet e ardhshme.

Drejtori Fetahu thekson që janë të planifikuara për fusha sportive shkollat “Shaban Shala”, “Hamit Sejdiu”, “Zahir Pajaziti” dhe në Kërpimeh janë të planifikuar për shkak të gravitimit për shkak të numrit të nxënësve.

Drejtori Osmani falënderon pjesëmarrësit për gjitha sygjerimet dhe propozimet duke u shprehur i hapur gjithmonë për diskutime.

10.06.2023

Podujevë



Kuvendi i Komunës së Durrëvës







Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Debat Publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2024-2026 (KAB), banorët e qytetit dhe lagjeve përreth.

Lista e nënshkrimeve të pjesëmarrëseve:

	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Nënshkrimi
1	Arif Halimi	Dhunnica	Arif Halimi
2	Musli Mustafa	PODUEVE	Musli Mustafa
3	Musli Musiqi	Leposhtice e Epa	Musli Musiqi
4	Fatmir Bekalari	Bojcinë	Fatmir Bekalari
5	Iskender Avazi	Shëngjil	Iskender Avazi
6	Fehmi Pollovi	Herëvicë	Fehmi Pollovi
7	Violla Breznica	Podujeve	Violla Breznica
8	Muhamed Galim	Dhunnica	Muhamed Galim
9	Shqip Dhegani	Bad Harë	Shqip Dhegani
10	Enver Halimi	Podujeve	Enver Halimi
11	Enver Mehana	Bojcinë	Enver Mehana
12	Bejtullah Namani	Shamalluk	Bejtullah Namani
13	MILAZIM NAMANI	SHAMALLUK	Milazim Namani
14	ADRIAN NAMANI	SHAMALLUK	Adrian Namani
15	SABEDIN NAMANI	SHAMALLUK	Sabedin Namani
16	Bekim Namani	SHAMALLUK	Bekim Namani
17	KOSOVARE NAMANI	SHAMALLUK	Kosovare Namani
18	Ismael Krasniqi	Najac	Ismael Krasniqi
19	Sadat Abdullahu	QKamnit	Sadat Abdullahu
20	Visar Dushi	Paloshice e poshtme	Visar Dushi
21	Ajzhe Aliu	Podujeve	Ajzhe Aliu

22	Bahrie Talla	Letanc	<i>[Signature]</i>
23	Sabahote Jakupi	Podujevë	<i>[Signature]</i>
24	Tarbo Nishaj	Podujevë	<i>[Signature]</i>
25	Teuta Berisha	Burice	<i>[Signature]</i>
26	Shukrije Zhitia	Podujevë	<i>[Signature]</i>
27	SELVIE HOXHA	PODUJEVË	<i>[Signature]</i>
28	Strijeta Bashota	Podujevë	<i>[Signature]</i>
29	Adil Haliti	Metëhi	<i>[Signature]</i>
30	Bashkim Lepaj	Bajcinë	<i>[Signature]</i>
31	Nysret Lemajli	Podujevë	<i>[Signature]</i>
32	Norim Bajrovic	Dalbën	<i>[Signature]</i>
33			
34			
35			

Vërejtje: Nënshkruhen të gjithë ata persona të cilët pajtohen që të dhënat e tyre dhe fotot mund të përdoren për publikim e procesit të konsultimeve në ueb faqen zyrtare të Komunës së Podujevës.

Podujevë

06.06.2023